



**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR STAF AKADEMIK**

**Pozicioni:** Lektor në departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike

Ky pozicion është i hapur për personel akademik shqiptar dhe të huaj

**Fusha specifike:** Algoritmikë, Intelligjence Artificiale dhe Sisteme Intelligjente

**Tipologjia:** Me kohë të plotë

**Data e fillimit:** Shtator 2021

**Afati i aplikimit:** 30.08.2021

Universiteti Metropolitan Tirana është një universitet i çertifikuar nga MASR i përbërë nga tre fakultete, Inxhinieri e Ndërtimit dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT. Numri i përgjithshëm i studentëve në UMT është rreth 1000, numër i cili ka pësuar një rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi të veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoraturës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe USA. Një rëndësi të veçantë i është dhënë internacionalizimit të aktiviteteve pedagogjike nëpërmjet një sërë marrëveshje me universitete evropiane dhe projektet Erasmus në mbështetje të mobilitetit të studentëve. Gjithashtu po i jepet një rëndësi e veçantë nënshkrimit të marrëveshjeve me ndërmarrjet evropiane dhe vendase për mbështetjen e aktivitetit pedagogjik dhe shkencor si dhe punësimin e studentëve të UMT.

## Universiteti Metropolitan Tirana rekruton një pedagog në Fakultetin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe IT

(pozicioni është i hapur për personel akademik shqiptar dhe të huaj)

Universiteti Metropolitan Tirana rekruton një pedagog-kërkues në fushën e Intelligjencës Artificiale dhe Matematikës pranë Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe IT (FSHKIT).

Ju jeni mbajtës i titullit të doktorit të shkencave dhe keni eksperiencën e nevojshme pedagogjike që ju mundëson implikimin tuaj afat shkurtër në programet e ndryshme pedagogjike të këtij fakulteti në nivelin Bsc ose Msc. Potenciali i juaj shkencor është konkretizuar me publikime shkencore në konferenca dhe revista shkencore të indeksuara dhe me faktor impakti si dhe në pjesëmarrjen tuaj në projekte shkencore dhe të zhvillimit.

Ju do të jeni i atashuar në departamentin e informatikës të FSHKIT i ngarkuar me programet e studimit të informatikës, software engineering si dhe me masterin e délokalizuar të ESIEE Paris në UMT i cili është një projekt që do të behet i mundur në shtator të 2022.

Përsa i përket mësimdhënies, ju do të përforconi ekipin pedagogjik të departamentit dhe do të merrni pjesë në programet e studimit të nivelit bachelor dhe master kryesisht në fushën e algoritmikës dhe të programimit. Ju do të merrni gjithashtu pjesë në udhëheqjen e projekteve të studentëve me një dimension aplikativ si dhe të diplomave të studentëve të masterit. Interesi juaj për inovacionin pedagogjik është një vlerë e shtuar për ju dhe për UMT.

Përsa i përket kërkimit shkencor, puna dhe eksperiencia juaj ateston potencial dhe kapacitet që ju keni për dialogun dhe shkëmbimin shkencor në disa fusha të aktivitetit të UMT. Ju keni një interes real për aplikacionet industriale dhe transferimin e teknologjisë dhe keni një projekt kërkimor që konvergjon me atë të FSHKIT i fokusuar tek Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Intelligjente.

Ju gjithashtu keni kapacitetin të ndërmerrni aksione pedagogjike dhe kërkimore në bashkëpunim me kolegë dhe institucione ndërkombetare dhe për këtë zotëroni të paktën gjuhën angleze qoftë për mësimdhënie por dhe për kërkim shkencor.

Kandidatët konkurrentë duhet të dërgojnë në format elektronik këtë dokumentacion:

- Kërkesë me shkrim.
- CV ( Curriculum Vitae) përfshirë listën e botimeve shkencore dhe referimeve në konferenca shkencore brenda ose jashtë vendit.
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit “Master i Shkencave” si dhe dëshmi e titullit “Doktor i Shkencave” apo tituj të tjerë akademikë, ose vërtetim të ndjekjes së ciklit të tetë të studimeve “Doktoratë”. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MASR), ose vërtetim që janë në proces njohje.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në [humanresources@umt.edu.al](mailto:humanresources@umt.edu.al)